



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura V**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 05  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303  
Prishtinë, më 28 janar 2015, në orën 11:00

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË**  
**DHE MIRËQENIE SOCIALE**

**Në mbledhje morën pjesë:** Njomza Emini, Fikrim Damka, Time Kadrijaj , Fadil Beka, Besa Baftiu, Shukrije Bytyçi dhe Hatim Baxhaku.

**Munguan:** Flora Brovina dhe Adem Hoxha.

**Të ftuar :** Imet Rrahmani , ministër i Ministrisë së Shëndetësisë.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

**Mbledhjen e kryesoi,** Njomza Emini, nënkryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

**RENDI I DITËS:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Takimi njoftues me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë, z. Imet Rrahmani. Diskutim lidhur me prioritetet dhe sfidat e ministrisë;
3. Shqyrtimi i draft- planit të punës së Komisionit për vitin 2015;
4. Të ndryshme.

***Kryesuesja*** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.*

## **2. Takimi njoftues me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë, z. Imet Rrahmani. Diskutim lidhur me prioritetet dhe sfidat e ministrisë**

**Njomza Emini**, falënderoi ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë, z. Imet Rrahmani që iu ka përgjigjur ftesës së Komisionit për të diskutuar për prioritetet dhe sfidat e Ministrisë së Shëndetësisë. Ftoi ministrin që të prezantojë para anëtarëve të Komisionit prioritetet dhe sfidat e Ministrisë së Shëndetësisë.

**Imet Rrahmani**, falënderoi për ftesën dhe theksoi se ka kënaqësinë që para Komisionit të paraqesë prioritetet dhe sfidat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe se është i kënaqur që bashkërisht me Komisionin, të diskutojnë për prioritetet dhe sfidat e ministrisë.

Është risi në qeverisje që shëndetësia për herë të parë është prioritet, pra është prioriteti i pestë i Qeverisë.

Kam përgatitur edhe një dokument të shkruar, të cilin do t'ua dorëzoj, por edhe do të paraqes disa nga pikat kryesore strategjike, për të cilat ministria është e angazhuar t'i realizojë. Si prioritet, parashihet zbatimi i reformës shëndetësore, duke u bazuar në Strategjinë sektoriale 2014-2020.

Sfida kryesore për këtë vit është ndryshimi i sistemit të financimit shëndetësor dhe funksionalizimi i fondit publik të sigurimeve shëndetësore. Tani jemi në themelime e sipër të Agjencisë për Sigurime Shëndetësore.

Objektiv tjetër është përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore dhe që është vazhdimësi. Shfrytëzimi optimal i resurseve profesionale nëpërmjet integritetit të shërbimeve shëndetësore në tri nivelet e kujdesit shëndetësor. Një nga sfidat themelore është edhe furnizimi i rregullt me barna dhe material harxhues nga lista esenciale.

Tjetër objektiv, në të cilën jemi duke punuar, është funksionalizimi i odave të profesionistëve shëndetësorë. Me ngritjen e kapaciteteve do të bëjmë edhe bartjen e kompetencave të parapara me ligj. Jemi edhe në fazën e konsolidimit të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar. Kjo është pjesë e reformës dhe jemi në fazën e finalizimit të statutit.

Pjesë e veçantë është edhe kompletimi i legjislacionit të nevojshëm për fushën e shëndetësisë. Këtë vit janë të parapara të hartohen dhe miratohen 5 ligje. Do të nxjerrën edhe rreth 30 udhëzime administrative që do të mbulojnë disa fusha të Ministrisë së Shëndetësisë.

**Njomza Emini**, theksoi se të gjithë anëtarët e Komisionit janë zotuar që bashkërisht do të punojmë që shëndetësia të jetë në nivelin e duhur.

**Besa Baftiu**, theksoi se një plan i punës është i mirëseardhur, por do të kishte qenë mirë ta kemi më herët. Ministri tha se kanë shumë objektiva dhe sfida, por nuk e ceku si objektiv luftimin e korrupsionit. Të gjithë e dimë se kancer i shëndetësisë në Kosovë është korrupsioni, prandaj pyes ministrin se cilët do të jenë hapat konkret që do t'i ndërmerr ministri në luftimin e korrupsionit.

**Fadil Beka**, theksoi se problemet në shëndetësi janë të grumbulluara për një kohë të gjatë dhe kërkojnë zgjidhje. Të filloj nga furnizimi me barna dhe material shpenzues, aferat e ndryshme korruptuese, numër i madh i specialistëve që kanë mbetur jashtë listave të pagave, më shumë se 60 specialistë të papunë, sfidë e rëndë janë edhe sigurimet shëndetësore etj. Ne jemi të përkushtuar të bashkëpunojmë në zgjidhjen e problemeve në shëndetësi dhe do të punojmë aq sa na lejojnë mundësitë.

Ju uroj punë të mbarë dhe bashkëpunim.

**Fikrim Damka**, përshëndeti ministrin dhe tha se takimi dhe bashkëpunimi i Komisionit me ministrin do të jetë i shpeshtë. Në legjislaturën e kaluar janë miratuar disa ligje shumë të

rëndësishme të fushës së shëndetësisë dhe këto ligje parashohin disa reforma shumë të mëdha në shëndetësi, sidomos decentralizimi. Pyeti: A mendoni se do të vazhdoni me këto reforma? Sa i përket Ligjit për sigurime shëndetësore, a do të fillojë të implementohet këtë vit? Sistemi i informimit shëndetësor deri ku ka arritur të implementohet, sepse pa sistem të informimit shëndetësor, nuk mund të ketë rezultate pozitive në shëndetësi? Ligji për produkte dhe pajisje medicinale, ka disa konfuzione në mes të neneve, sepse në seancën kur është miratuar, ka pasur disa votime në kolizion neni me nen. Si do ta zbatoni atë ligj, a do të propozoni ndryshimin e tij?

**Time Kadrijaj**, përshëndeti ministrin dhe tha se shëndetësia ballafaqohet me probleme të shumta dhe se nuk është problem vetëm buxheti i vogël i shëndetësisë, por ka edhe keqmenaxhim dhe keqpërdorim të detyrave zyrtare dhe kjo shihet edhe nga aferat e shumta që kanë ndodhur në sektorin e shëndetësisë, duke filluar nga vetë Ministria e Shëndetësisë.

Ne po presim programin qeverisës dhe konkretisht programin për sektorin e shëndetësisë, në mënyrë që të shohim se cilat janë prioritetet e sektorit të shëndetësisë. Një çështje që mua më intereson, është zbatimi i Ligjit të sigurimeve shëndetësore. Çështja që ju e cekët, pra e hartimit të statutit të SHSKU, duke ditur që ky statut është miratuar, është kthyer prapë dhe është hartuar disa herë. A jeni të informuar se a ka pasur mangësi apo nuk ju ka përshtatur ministrit që ka qenë, sepse në statut parashihet edhe zgjedhja e drejtorëve të klinikave dhe të spitaleve rajonale, a do të hartoni një statut funksional dhe të përshtatshëm për njerëzit që udhëheqin këtë dikaster? Nga miratimi i buxhetit e dimë se është rritur buxheti për barna të listës esenciale, por deri më tani nuk ka qenë furnizimi me barna as deri në 30% nga lista esenciale, por nuk ka qenë furnizimi i rregullt as me barna të listës vitale, sipas jush, sa mendoni që do të jetë përqindja e furnizimit të institucioneve shëndetësore me barna të listës esenciale?

**Hatim Baxhaku**, shprehu gatishmërinë e bashkëpunimit me ministrin për përballje me problemet që janë në sektorin e shëndetësisë. Do të ceki disa nga problemet më urgjente dhe më të nevojshme për t'u adresuar. Së pari janë politikat e aftësimit dhe edukimit shëndetësor. Kujdes të posaçëm duhet të ketë te ndarja e specializimeve që duhet të ketë një plan konkret, e jo specialistët të mbesin rrugëve. Shumë specializantë kanë mbetur pa paga, pra të bëhet planifikimi i ndarjes së specializimeve dhe specializantët të kenë të ardhura.

Çështje tjetër, është aftësimi i vazhdueshëm profesional ku thuhet se ndahen mjete të caktuara, por asnjëherë askujt nuk na është dhënë asnjë cent për të ndjekur ndonjë kongres apo simpozium jashtë vendit, duke ditur që çdo mjek është obligim t'i mbledhë një numër të caktuar të poenëve për t'u rilicencuar.

Gjatë hartimit të statutit të SHSKU, ka pasur disa diskutime dhe kjo mënyrë e organizimit është kundërshtuar, sepse në një anë flitet për decentralizim, ndërsa në anën tjetër është autonomia e spitaleve rajonale. Nëse rishqyrtohet ky statut, duhet të kihet parasysh centralizimi i tejskajshëm që ka ndodhur.

Problem tjetër është sistemi i informimit shëndetësor, i cili është një prej të metave më të mëdha të sistemit shëndetësor. Ai është problem i planifikimit, i statistikave, dhe i shumë çështjeve tjera.

**Shukrije Bytyçi**, e falënderoi ministrin për përgjigje në ftesë dhe tha se të gjithë e dinë që shëndetësia ka probleme të mëdha, por është mirë që kësaj here shëndetësia është një nga prioritetet e Qeverisë. Shpresoj që ky prioritet do të jetësohet. Ministri do ta ketë përkrahjen tonë, pa dallime partiake. Kisha kërkuar që lufta kundër krimit dhe korrupsionit të jenë prioriteti juaj si ministër.

Në Kosovë po ballafaqohemi me shumë sëmundje të rënda dhe qytetarët po maltretohen duke kërkuar shërim jashtë vendit dhe kërkoj që të jetë prioritet i juaji vendosja e rregullit në

shëndetësi. Nuk ka çmim që e paguan punën e mjekut, por duhet që mjekët të jenë të gatshëm, që të jenë në shërbim të pacientit. Të inspektohen klinikat private sesi ato kanë mundur të kenë aparatura më të shtrenjta se spitalet shtetërore.

Kisha kërkuar që sa më parë të vijë plani i punës së ministrisë dhe të mund të punojmë dhe monitorojmë realizimin e tij. Përkrahjen tonë do ta keni pa rezervë.

**Time Kadrijaj**, theksoi se shumë specializantë kanë kërkuar që të financohen nga Ministria e Shëndetësisë gjatë specializimit. A do të fillojnë të financohen këta specialistë?

Problem tjetër është referimi i pacientëve, ku bëhet referimi i panevojshëm nga spitalet rajonale për në Qendrën Emergjente në QKUK.

A do të intervenoni në Qendrën Emergjente që të ketë një infrastrukturë më të mirë? Gjithashtu, edhe mjekimi intensiv qendror nuk është në gjendje të mirë dhe ka vetëm 13 shtretër. Prioritet i juaj duhet të jetë intervenimi në mjekimin intensiv qendror.

**Njomza Emini**, tha se edhe unë kam disa shqetësime dhe disa pyetje. Fillimisht, lidhur me skandalet që kanë ndodhur në disa spitale private, ku ka mbetur çështja dhe deri ku ka mbërri? Gjithashtu, do të ishte mirë që Ministria e Shëndetësisë të na paraqesë raport financiar çdo tre muaj. Dhe e treta, kur do të fillojë zbatimi i Ligjit të sigurimeve shëndetësore?

**Imet Rrahmani**, tha se të gjitha problemet e ngritura janë probleme reale dhe jemi të angazhuar të punojmë maksimalisht që të gjejmë zgjidhje.

Më vjen keq që në shëndetësi ka shumë afëra korruptive, por ky problem është multisektorial dhe jemi të përkushtuar që të ndahet e mira nga e keqja.

Jemi në fazën e konsolidimit dhe të auditimit të shumë çështjeve, dhe varësisht prej gjetjeve, do t'i procedojmë konform ligjeve. Prokurimi online që do të instalohet në të gjitha njësitë, do ta eliminojë në masë të madhe çështjen e korrupsionit dhe është një nga prioritetet e qeverisjes.

Në këtë drejtim, do të ndihmojë edhe bashkëpunimi me shoqatën e pacientëve, ku pacientët do të dërgojnë ankesat e tyre konkrete .

Ankesa të shumta dërgohen edhe në drejtim të Inspektoratit Shëndetësor të Kosovës dhe mendoj se duhet që Inspektorati Shëndetësor të trajtohet me seriozitet dhe sa më parë të miratohet edhe plotësim- ndryshimi i Ligjit për Inspektoratin Shëndetësor.

Sa i përket sigurimit shëndetësor, nuk mund të jap ndonjë datë, por jemi duke punuar intensivisht që të fillojë implementimi sa më shpejt.

Sistemi i informimit shëndetësor, pilot-projekti për Prizren, QKUK-në dhe në Prishtinë, do të fillojë në shkurt dhe do të provohet që brenda vitit të funksionalizohet në tërë Kosovën.

Në bazë të sistemit të informimit shëndetësor, do të merren përfundime edhe për pakon e sigurimeve shëndetësore. Në bazë të dinamikës që kemi paraparë, në mes të vitit, do të fillojmë me mbledhjen e premiumeve, ndërsa kur të përfundojnë të gjitha veglat të cilat do të na mundësojnë funksionalizimin e fondit të sigurimeve shëndetësore, do startojmë me dhënien e sigurimeve shëndetësore. Objektivi është fillimi i vitit tjetër.

Statuti i SHSKU, kemi pasur vërejtje edhe nga partnerët tanë dhe do të ketë nevojë për një ndërhyrje në statut. Sigurimet shëndetësore do të stabilizojnë edhe shumë sfera tjera, e këtu edhe referimet e pacientëve.

Lista esenciale, jemi në fazën e riaktivizimit të çështjes së udhërrëfyesve klinikë. Krijimi i udhërrëfyesve klinikë në mënyrë automatike nxjerr edhe listën esenciale reale. Vitin e kaluar 62% ka qenë furnizimi nga lista vitale, ndërsa 40% nga lista esenciale. Natyrisht, tentojmë që ky furnizim të jetë 100%.

Licencimet dhe rilicencimet janë bërë me vendime politike, nuk ka pasur ndonjë sistem të mirëfilltë. Ne jemi duke punuar në funksionalizimin e odave të profesionistëve shëndetësorë dhe

çështja e licencimit dhe rilicencimit do të kalojë te odat. Një fond për edukim të vazhdueshëm është ndarë, por nuk ka qenë i mjaftueshëm .

Nuk jemi të kënaqur me mënyrën e ndarjes së specializimeve dhe mënyrën e pagesës së specialistëve vullnetarë.

Qendra emergjente, vitin e kaluar, ka pasur rreth 50 mijë shërbime dhe nuk kanë kushte të mira të punës . Është projekti dhe janë ndarë mjete për një qendër të re emergjente në QKUK.

Gjithashtu, edhe mjekimi intensiv është në gjendje të keqe dhe nuk i përmbush nevojat. Janë disa projekte, por ende nuk janë të konkretizuara. Nuk presim një zgjidhje të shpejtë.

Kemi gatishmëri politike edhe me Tiranën, konkretisht me Ministrinë e Shëndetësisë të Shqipërisë që të bashkëpunojmë, sidomos sa i përket kardiokirurgjisë dhe kardiologjinë invazive.

U mundova t'i përmbledh të gjitha pyetjet dhe të jem konkret. Jam i gatshëm për bashkëpunim me Komisionin dhe me anëtarët e Kuvendit.

**Time Kadrijaj**, ceku se Ministria e Shëndetësisë e ka degraduar vetë punën e Inspektoratit Shëndetësor, duke pas parasysh koeficientet e ulët që i kanë inspektorët, në krahasim me punëtorët tjerë në Ministrinë e Shëndetësisë. Puna e inspektoratit është një punë shumë e rëndë, prandaj duke e ditur se puna e tyre është shumë specifike, duhet rritur koeficientet dhe duhet paguar edhe rrezikshmëria, në mënyrë që t'i motivojmë për punë.

A do të avanconi inspektoratin me paga dhe me çfarëdo forme tjetër dhe a do të rritet numri i inspektorëve shëndetësorë, në mënyrë që të ketë mbikëqyrje të vazhdueshme?

Çka do të ndërmerri lidhur me agjencinë e barnave, duke e ditur se ky sektor është shumë i përfolur, a do të jetë prioritet i Qeverisë tuaj, në mënyrë që edhe ky dikaster të punojë si duhet, çfarë do të ndërmerri ?

**Imet Rrahmani**, theksoi se është një nga prioritetet Inspektorati Shëndetësor, respektivisht definimi i çështjeve të inspektoratit shëndetësor dhe atij farmaceutik. Është në plotësim-ndryshim edhe Ligji i inspektoratit, por ne nuk do të presim deri në miratimin e ligjit, por duhet t'u dalim në ndihmë edhe më herët.

Do ta hapim konkursin për zgjedhjen e shefit të AKPPM-së, por kemi sinjale pozitive nga puna që është duke u bërë në këtë agjenci.

**Time Kadrijaj** , propozoi që të bëhet krahasimi i koeficienteve të inspektorëve shëndetësorë me zyrtarët e tjerë të ministrisë, si dhe të matet performanca e punës së inspektorëve shëndetësorë dhe e zyrtarëve tjerë që punojnë në ministri. Vetë Ministria e Shëndetësisë i ka demotivuar për punë inspektorët shëndetësorë.

**Imet Rrahmani**, theksoi se e kanë vërejtur këtë dallim, qoftë të inspektorëve shëndetësorë dhe punëtorëve të ministrisë, qoftë te dallimi edhe me inspektoratet e ministrive tjera dhe do të angazhohemi për gjetjen e një zgjidhjeje.

**Besa Baftiu**, tha se ministri e ceku mosdistribuímin e mirë të mjekëve specialistë nëpër qendrat rajonale dhe kjo është një brengë e të gjithëve, sepse edhe në Spitalin Rajonal të Gjilanit, nuk është distribuími i mirë , si për shembull në Kamenicë dhe në Viti, nuk ka fare gjinekolog, ndërsa në spitalin e Gjilani ka më tepër se nevojat. Çfarë do të ndërmerri për distribuímin më të mirë të mjekëve edhe në këto qendra?

**Fadil Beka**, pasi nuk u cek dhe jemi nën presionin e sindikatave të cilët kanë paralajmëruar greva, çfarë është ndërmarrë në këtë drejtim?

**Imet Rrahmani**, tha se sindikatat kanë paralajmëruar greva prej 24 orësh dhe kërkesat janë implementimi në tërësi i kontratës kolektive, të vendoset dialogu social dhe të respektohet Ligji për pagat. E respektojmë të drejtën për grevë, në përputhje me ligjet. Jemi të gatshëm të bisedojmë me sindikalistët për zgjidhjen e problemeve. Këtë vit do të fillojë vetëm pagimi i përvojës së punës. Do të kemi edhe takime të vazhdueshme me sindikatat.

Rreth shpërndarjes së specialistëve, nuk di se çfarë mund të bëj, sepse duke pasur parasysh edhe ligjet në fuqi, është një çështje mjaft komplekse.

Ju përshëndes dhe jam i gatshëm për bashkëpunim.

**Njomza Emini**, theksoi se të gjithë do të angazhohemi që çështjet në shëndetësi të avancohen dhe e falënderojmë ministrin për bashkëpunim.

### **3. Shqyrtimi i draft- planit të punës së Komisionit për vitin 2015**

**Njomza Emini**, tha se sipas vendimit të Kryesisë së Kuvendit, deri më 2 shkurt 2015, duhet ta miratojmë planin e punës së Komisionit. Draftin e kemi marrë nga administrata, a ka ndonjë propozim për plotësim të planit?

Kemi pasur plane për mbajtje të punëtorisë, por pasi është kërkesa e Kryesisë së Kuvendit, ndoshta tani duhet ta miratojmë planin e punës, ndërsa më vonë mund edhe të plotësohet plani i punës.

*Pas diskutimeve, Komisioni, njëzëri, miratoi Planin e punës së Komisionit për vitin 2015.*

### **4. Të ndryshme**

Në pikën të ndryshme, **Fadil Beka** propozoi që të realizohet një takim me sindikatat e shëndetësisë dhe të diskutohet për grevën e paralajmëruar.

Pas diskutimeve, u vendos që për shkak të kohës së shkurtër, pra deri të premtën kur do të mbahet greva, nuk ka kohë të mbahet takimi.

**E përqatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Nënkryetarja e Komisionit,**

---

**Njomza EMINI**